



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 573/Prot.

2

Tiranë, më 31/01/2022.

URDHËR

Nr. 13 datë 31/01/2022

“PËR DHËNIEN E MASËS DISIPLINORE PARALAJMËRIM ME SHKRIM, GJOBË NË MASËN 100 000 LEKË DHE KRYERJEN E TRAJNIMIT VAZHDUES SHITESË, PËR NOTEREN [REDACTED]”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 dhe 7, të Ligjit Nr.8678, datë 14.05.2001 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të gërmës “a”, “c”, “ç”, të pikës 2, pikës 4, si dhe pikës 5, të nenit 26, të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”,

KONSTATOJ:

Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.550, datë 24.09.2021 “Për fillimin e hetimit të shkeljeve disiplinore, për noterin [REDACTED]”, grupi i hetimit i përbërë nga nëpunësit e Ministrisë së Drejtësisë në datën 28.10.2021 zhvilloi seancën dëgjimore me noterin [REDACTED], në lidhje me konstatimet e realizuara në Raportin për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm nr. [REDACTED] Prot., datë 30.08.2021, sipas Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. [REDACTED] datë 14.04.2021 “Për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm pranë noterit [REDACTED]”, si dhe në lidhje me hartimin e aktit nr. [REDACTED] Rep., nr. [REDACTED] Kol., datë 07.04.2021 “Kontrata të tjera (Kontratë kalimi e të drejtave reale)”, sipas ankesës së znj. [REDACTED] të paraqitur me ankesën nr. [REDACTED] Prot., datë 22.07.2021.

Hetimi i shkeljeve disiplinore, u realizua në përputhje me pikën 7, të nenit 25, si dhe nenit 29, të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”.

Me shkresën nr.4783 Prot., datë 29.09.2021, noterja është njoftuar në lidhje me fillimin e hetimit disiplinor, si dhe me gjetjet e Raportit për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm nr.2181/5 Prot., datë 30.08.2021, me qëllim paraqitjen e argumentave në vijim të gjetjeve të realizuara.

Në vijim, me shkresën nr.4783/1 Prot., datë 22.10.2021, noterja është njoftuar në lidhje me faktin që nuk janë paraqitur argumenta apo observacione sipas gjetjeve të realizuara, ku në zbatim të pikës 1, të nenit 36, të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, “1. Ministri i Drejtësisë, kur vlerëson se marrja në pyetje e noterit ose zëvendësnotërit, dëshmitarëve ose personave të tjerë paraqet rëndësi për hetimin, i njofton ata lidhur me kohën dhe vendin e seancës së marrjes në pyetje”, noterja është njoftuar mbi paraqitjen e saj në ambjentet e Ministrisë së Drejtësisë në datë 28.10.2021, ora 10:00, me qëllim zhvillimin e seancës dëgjimore. Ky njoftim është realizuar edhe nëpërmjet e-mailit, dërguar në datë 22.10.2021, në adresën elektronike [REDACTED].

Në datë 23.10.2021, noterja është përgjigjur në mënyrë elektronike, duke u shprehur se *“Uroj që kjo të jete një menyre komunikimi e vlefshme për ne, pasi mesa ve re posta nuk ka qene rruga e duhur për të marrë përgjigjet e mia (për të qene korrekt me ju dhe veten une i kam ruajtur të gjitha leter njoftimet e postes dhe po jua dergoj). Ne përgjigje të shkreses suaj serish po ju nis përgjigjet e mia, kete here të skanuara dhe jo me poste. Pavaresisht kesaj, duke qene se mes nesh do të realizohet takimi, do të kemi mundesine të shëkmbejme informacionet dhe kërkesat qarte. Për tju vene juve në dispozicion fizikisht dokumentacionin une do të paraqitem kete here përsônâlisht pranë Ministrise së Drejtesise dhe protokolloj dosjen para takimit tone”*.

Në vijim, me e-mailin e datës 25.10.2021, noterja është njoftuar se sipas verifikimit të kryer pranë Postës Shqiptare (print screen bashkangjitur), shkresa së bashku me raportin dhe urdhrin për fillimin e hetimit disiplinor është marrë në dorëzim në datë 01.10.2021, ora 16:43. Megjithatë, në kuadër të takimit që do të realizohej, në mënyrë të skanuar janë dërguar Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr.550, datë 24.09.2021, si dhe Raporti për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm nr.2181/5 Prot., datë 30.08.2021.

Në këto kushte, në datë 28.10.2021, në orën 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore me noteren ~~_____~~ e cila në përfundim është transkriptuar, zbardhur dhe hedhur në CD, i cili i është vendosur në dispozicion noteres pas përfundimit të saj, ndërkohë që transkripti është dërguar në mënyrë elektronike në datë 01.11.2021.

Nga analizimi i akteve noteriale të marra në shqyrtim, është konstatuar se:

Nga ana e noteres në pjesën më të madhe të akteve nuk është vendosur baza ligjore e nevojshme, i cili konsiderohet si një element i nevojshëm me qëllim që akti noterial të jetë sa më i plotë, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

Në disa nga aktet noteriale të cituara më sipër nga ana e noteres nuk është përmbushur gërma “nj”, e pikës 1, të nenit 62, të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, ku është përcaktuar se, *“1. Noteri, përveç kompetencave të parashikuara në ligje të veçanta, harton akte, kryen njësimë, vërtetime dhe verifikime në të gjitha çështjet, duke përfshirë, por pa u kufizuar: nj) kërkon nga personat fizikë e juridikë të dhëna e dokumente që janë të domosdoshme për kryerjen e akteve dhe veprimeve noteriale”*.

Në disa prej akteve noteriale të analizuar më sipër, nga ana e noteres, nuk është realizuar verifikimi i gjendjes pasurore, duke mos përmbushur parashikimin ligjor në pikën 1, të nenit 126, të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, ku është përcaktuar se *“1. Akti noterial për kalimin ose njohjen e pronësisë mbi sendet e paluajtshme, ose të një të drejte reale mbi to, kryhet nga noteri, pasi të ketë verifikuar pronësinë e palës nëpërmjet sistemit elektronik mbi pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij verifikimi, pala i paraqet noterit dokumentet e pronësisë të nevojshme, si dhe autorizimin e saj me shkrim. 2. Noteri shënon në aktin noterial për kalimin e pasurisë së paluajtshme, verifikimin e bërë, dhe i bashkëlidh rezultatin e verifikimit”*.

Në kushtet kur në aktet dhe veprimet noteriale të hartuara/redaktuara u konstatuan shkelje thelbësore të ligjit nr.110/2018 “Për noterinë” dhe akteve nënligjore që disiplojnë veprimtarinë e noterëve, grupi i kontrollit, duke mbajtur në konsideratë parimin e proporcionalitetit dhe shkallën e pakujdesisë së noterit në zbatim të pikës 2/a, 2/c dhe 2/ç, si dhe në harmoni me parashikimet e pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”,

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 dhe 7, të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të gërmës "a", "c", "ç", të pikës 2, pikës 4, si dhe pikës 5, të nenit 26, të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë".

URDHËROJ:

1. Dhënie e masës disiplinore "paraljmërim me shkrim, gjobë në masën 100 000 lekë dhe kryerjen e trajnimit vazhdues shtesë, në fushën e hartimit të akteve noteriale sipas parashikimeve të pikës 1/b dhe 1/c të nenit 63, të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", [redacted], anëtare e Degës Vendore të Noterisë Tiranë.
2. Noterja [redacted] të marrë të gjitha masat për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, që lidhen me ushtrimin e rregullt të veprimtarisë noteriale, sipas parashikimeve të Ligjit 110/2018 "Për noterinë" dhe akteve nënligjore në fuqi.
3. Ndaj këtij urdhri, noterja mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.
5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.
6. Ngarkohet Qendra Shqiptare e Trajnimit të Noterëve, për marrjen e masave dhe zhvillimin e trajnimit vazhdues shtesë për noterën [redacted], sipas parashikimeve të pikës 1/b dhe 1/c, të nenit 63, të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë".
7. Ky Urdhër t'i njoftohet menjëherë noteres Stela Demneri, Degës Vendore të Noterisë Tiranë, Dhomës Kombëtare të Noterisë, si dhe Qendrës Shqiptare të Trajnimit të Noterëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ulsi Manja

